

ABSTRAKTI

Teknologjia ka sjellë ndryshime të mëdha në jetën e përditshme, duke transformuar mënyrën si jetojmë dhe punojmë. Ajo ka hapur mundësi të reja dhe ka sjellë sfida për çdo fushë të jetës, duke i ofruar shoqërisë mundësi për zhvillim të pandërprerë. Gjatë dekadave të fundit, inovacionet në teknologji, si interneti, kompjuterët, automatizimi dhe inteligjenca artificiale, kanë ndikuar në mënyrën se si shkëmbejmë informacion dhe kemi qasje në të dhëna, duke na lidhur me botën në një mënyrë që ishte e paimagjinueshme më parë. Ky zhvillim i shpejtë ka ndihmuar në avancimin e shumë sektorëve, përfshirë arsimimin, shëndetësinë dhe industrinë.

Një fushë që ka përfituar ndjeshëm nga këto ndryshime është arsimi. Teknologjia ka pasur një ndikim të dukshëm në mënyrën e mësimdhënies dhe të të nxënit. Përdorimi i platformave online, aplikacioneve edukative dhe materialeve multimediale ka mundësuar një qasje më të gjerë dhe më të thellë në informacion, duke ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësi dhe njohuri të reja. Po ashtu, teknologjia ka sjellë mundësinë për një mësim më të personalizuar, ku secili nxënës mund të mësojë në ritmin dhe mënyrën që i përshtatet më mirë. Për mësuesit, teknologjitë kanë hapur mundësi për zhvillimin e metodave më interaktive dhe kreative, të cilat rrisin angazhimin e nxënësve dhe e bëjnë mësimin më tërheqës.

Në këtë kontekst, teknologjitë si Realiteti Virtual (RV) dhe Realiteti i Miksuar (RM) janë bërë gjithnjë e më të përdorura në arsimin modern. Ato ofrojnë mundësi për të krijuar përvoja mësimore të reja dhe më të pasura, duke mundësuar që nxënësit të angazhohen në mësim në mënyra më interaktive dhe të realizojnë aktivitete që ndihmojnë në kuptimin e koncepteve të ndërlikuara. Në këtë studim, është shqyrtuar ndikimi që këto teknologji kanë në mësimin e matematikës, veçanërisht në lëndën e gjeometrisë, duke u fokusuar në arsimin parauniversitar. Studimi do të analizojë se si përdorimi i RV dhe RM ndikon në motivimin e nxënësve dhe rezultatet e të nxënit, si dhe do të përpiqet të identifikojë përfitimet dhe mundësitë që ofron përdorimi i këtyre teknologjive për përmirësimin e mësimin të matematikës.

Për realizimin e këtij hulumtimi, është përdorur një model kuazi-eksperimental, që ka përfshirë dy grupe: një grup eksperimental dhe një grup kontrolli. Ky model ka mundësuar mbledhjen e provave dhe të dhënave për efektivitetin e përdorimit të teknologjive RV dhe RM në procesin

mësimor. Procedurat e ndjekura përfshijnë testimin paraprak të njohurive të nxënësve, ndërhyrjen me teknologjitë RV dhe RM, pastestin për vlerësimin e përparimit dhe mbledhjen e të dhënave mbi motivimin dhe angazhimin e nxënësve gjatë procesit. Kjo metodologji ka mundësuar një vlerësim të hollësishëm të ndikimit që kanë këto teknologji në mësimin e gjeometrisë dhe ofron sugjerime për përdorimin e tyre në praktikën mësimore.

Rezultatet e këtij studimi janë analizuar përmes softuerit SPSS dhe kanë treguar një rritje të dukshme në rezultatet e nxënësve pas përdorimit të teknologjive RV dhe RM. Mesatarja e notës së nxënësve në grupin eksperimental u rrit për 1 notë, ndërkohë që klasa e kontrollit nuk pati asnjë ndryshim të dukshëm. Po ashtu, është vërejtur një rritje prej 76% në motivimin e nxënësve për të mësuar gjeometrinë, që tregon ndikimin pozitiv të këtyre teknologjive në angazhimin e nxënësve. Gjithashtu, rezulton se gjinia ka pasur një rol të rëndësishëm, me një ndikim 29% më të theksuar për vajzat në krahasim me djemtë, duke sugjeruar se reagimi ndaj teknologjisë mund të ndryshojë në varësi të faktorëve të tillë si gjinia.

Ky studim ofron një vlerësim të rëndësishëm për ndikimin e teknologjive RV dhe RM në përmirësimin e mëimit të gjeometrisë dhe mund të shërbejë si udhëzues për përdorimin e këtyre teknologjive në mjediset mësimore. Rezultatet e studimit sugjerojnë që përdorimi i këtyre teknologjive mund të ndihmojë në rritjen e angazhimit të nxënësve dhe në përmirësimin e performancës së tyre, duke krijuar mundësi për një mësim më efektiv dhe më tërheqës.

Fjalët kyçe: RM, RV, gjeometri, teknologjia në arsim, matematika.

Tema: Ndikimi i teknologjive të realitetit virtual dhe të mikësuar në motivimin dhe rezultatet e nxënësve të koncepteve gjeometrike

Kandidati: Enes BERVENIKU